Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 96/17
Data/Datum. 27.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	96/17
PËR:	Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Komuna e Gjilanit** Parashtruesit të ankesës: **N.N.P."Engineering"** me seli në Viti
CC:	Panelit Shqyrtues në OSHP, Arkivës në OSHP
NGA:	Basri Fazliu - Ekspert Shqyrtues i Prokurimit
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **N.N.P."Engineering"** me seli në Viti, me numër protokollit:**96/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i urave në lagjen Biçak, Bilallët, Limonët dhe në lagjen Kurteshaj-Bresalc"**, me nr. të prokurimit: **651/16/069/521**, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues: (AK)– **Komuna e Gjilanit**

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	**27.04.2017**
PËR AKTIVITET			X

Bazuar në nenin 113.1 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i urave në lagjen Biçak, Bilallët, Limonët dhe në lagjen Kurteshaj-Bresalc"**, me nr. të prokurimit: **651/16/069/521**, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Komuna e Gjilanit**, si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **N.N.P."Engineering"** me seli në Viti, me numër protokollit: **96/17.**

Konform nenit *113.1,* Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		18.04.2017		**19.04.2017**		**27.04.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Më datën 04.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE: **N.N.P."Engineering"** me seli në Viti, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i urave në lagjen Biçak, Bilallët, Limonët dhe në lagjen Kurteshaj-Bresalc"**, me nr. të prokurimit: **651/16/069/521,** iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK) – **Komuna e Gjilanit.**
Konform nenit 113.1, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109, - Operatoret Ekonomik Ankues: N.N.P."Engineering" me seli në Viti

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.
- Është shkelur neni 59 pika 4 i LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).
- Neni 69 i LPP-së, Aftësitë Teknike dhe/ose Profesionale, par. 2.1, 4.1 dhe 6.1
- Legjislacioni dytësor nenet 1.2.3 dhe 4.
- Neni 108A i LPP-së, par. 6.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Fillimisht ju njoftojme se ne kemi qene ankues në herën e parë dhe na është aprovuar ankesa nga ana e juaj si e bazuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim duke e shpallur OE të rekomanduar për kontrate nga AK-ja si të papërgjegjshëm.
AK-ja përmes formularit B46 na ka njoftuar se oferta e jonë është e përgjegjshme. Njoftimi për dhënien e kontrates është pergaditur me date 13/03/2017 dhe është publikuar me date 14/03/2017 ne veb', zyrtare të Krrpp-se,kriter i dhenjies se kontrates ka qene oferta me e lire e përgjegjshme,me date 13/03/2017 AK-ja me anen e formualrit B46 na ka njoftuar se oferta e jone është e përgjegjshme por çmimi ka qene më i lartë se i OE të shpërblyer me kontrate,te njejten dite i kemi bërë kerkese Autoritetit Kontraktues përmes emaileve për qasje në dokumentacinin tone si OE dhe në oferten e OE te shperblyer me kontrate dhe Operatoret e tjerë.
Qasja nuk na është dhënë dhe përmes Arhives së Komunes me date 16/03/2017 kemi bërë kërkesë për Rishqyrtim pasi që ky është Rivleresim sepse OSHP-ja ka nxjerr vendim te cilin e ka publikuar me date 06/02/2017 në faqen zyrtare të saj ku Konzorciumin e shpallur fitues nga AK-ja, Komuna e Gjilanit konform LPPK e ka shpallur te papergjegishem, duke u bazuar ne atë se heren e parë na është mundesuar qasja në dokumentacionin e këtij konzorciumi mbetemi prane pretendimeve të njejta dhe e kemi vërtetuar se në Oferten e OE të shpërblyer me kontrate te menagjeri i projektit ing. i ndërtimit z.Ridvam Aliu i mungon kontrata apo parakontrata për punësimin e tij të OE Hajrushi në dosje është një faqe me nene nga neni 5 deri në nenin 10 por pa afate të caktuara dhe pa definime se në qfare cilësie angazhohet z.Aliu.Konsiderojme se i njejti nuk ka lidhur asnjë lloj detyrimi ndaj këtij OE dhe se këtij konzorciumi i mungon

ingjinjeri i ndërtimit dhe si i tillë kjo oferte është e papërgjegjshme dhe komisioni i vleresimit ka bërë shkelje gjatë egzaminimit dhe vlerësimit të ofertave duke rekomanduar për kontratate një Konzorcium i cili është papërgjegjshem.
Gjatë egzaminimit të dosjes së konzorciumit te shpallur fitues shihet se komisioni i vleresimit nuk e ka konsideruar si oferte ab-normalisht të ulët edhe pse parashikimi i AK-së ka qenë 110,000.00 euro ndërsa Oferta e shperblyer është 49,555.02 Euro zbërthyer në përqindje 55% nën parashikimin e AK-së.
Duke qene se oferta e shpërblyer është 28% më e lirë se dyta ,dhe 36.58% me e lire se mesatarja e Ofertuesve në këtë tender dhe kushti i tretë janë me shume se tre ofertues, AK-ja ka bërë shkelje duke mos zbatuar Legjislacionin dytësor për tenderet Abnormalisht te Ulet , duke bërë shkelje të neneve respektivisht nenet 1,neni 2,neni 3 gjegjesisht 3.1 dhe 3.2,dhe neni 4 gjegjësisht 4.1,4.2 4.3,4.4,4.5 dhe 4.6.
Duke mos zbatuar rregulloren e tillë dhe duke e trajtuar si oferte normale komisioni vlerësues bashke me AK-në ka bërë shkelje te LPP-së.
AK-ja këkesen tonë për rishqyrtim e ka marre me date 16/03/2017 ndërsa përgjigjen e ka kthyer me date 31/03/2017 përmes emailit duke shkelur ligjin e prokurimit nenin 108A pika 6 i cili nëe mënyre të qartë definon afatet kohore për kthim të përgjigjes OE i cili është ankimuar.
Në përgjigjen e AK-së përmes emailit të datës 31.03.2017 shihet qartë tendenca për manipulim me data ku shkruan se te bashkangjitur keni pergjigjen te cilen ju keni dërguar me date 20.03.2017 petines zyres per inforntata Inc qytetar.Ne dokumentin e derguar nga AK i pavulosur,ku shkruan se eshte pergaditur me date 20/03/2017 por neve na eshte derguar me date 31/03/2017 edhe pas dërgimit të emailit nga ana e jonë ku kërkojme sqarime nga AK-ja se pse e kanë vonuar përgjigjen, e tek të nesërmen AK-ja na e dergon përgjigjen përmes emailit,te bashkangjitur e keni shkresen e komunikimit me AK-në.
Në përgjigjen e AK-së,i njejti nuk ka ofruar fakte se e ka trajtuar si tender abnormalishte te ulet dhe duke e propozuar për kontrate të njejtin konzorcium nuk e ka perfill vendimin e OSHP-se nr. 478/16 të datës 06/02/2017.
Kërkojmë që AK-ja ta rishqyrtoje këtë ankese dhe të bëjë rivleresim te ri duke e shpallur Konzorciumin G&A Construction & Hajrushi si tender i papërgjegjshen dhe te na rekomandoje neve për Kontrate.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP:	06.09.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e Hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Punë/vlerë e Mesme
Vlera e parashikuar e kontratës:	110,000.00 Euro
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	28.09.2016
Data e hapjes së ofertave:	28.09.2016
Data e njoftimit për dhënie të kontratës në KRPP:	13.03.2017
Kriter për dhënien e kontratës:	Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët.

Kriteret për vlerësim:

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklarata nën betim, Zotimin e OE se i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65
2. Dëshminë se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.

Dëshminë nga gjykata ekonomike se OE se i përmbush kriteret sipas nenit 65 të LPP

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65 e nënshkruar dhe vulosur për secilin partner të një grupi operatorësh ekonomik(**formularin që është pjesë dosjes së tenderit**).
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit (apo të ket marrëveshtje mbi riprogramimin e borgjit me ATK-n) - ***për operatorin ekonomik i cili shpërblehet me kontrat origjinal***
3. Dëshminë nga gjykata ekonomike se OE se i përmbush kriteret sipas nenit 65 të LPP- ***për operatorin ekonomik i cili shpërblehet me kontrat origjinal ose kopje e noterizuar***

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

1. Certifikata e biznesit veprimtaria përkatëse
2. TVSH

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1 Certifikata e biznesit veprimtaria përkatëse-***kopje.***

3. *TVSH* ***kopje***

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Qarkullimi bankar në tri vitet e fundit duhet të jet 200,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Qarkullimi bankar në tri vitet e fundit të dëshmohet me qarkullim bankar ose me raporte të auditorëve të pavarur dhe të licencuar.

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Kontrata për punë të ngjajshme (ndërtimi i urave ose objekte të ndërtimit të lartë) për tri vitet e fundit së paku dy kontrata
2. Menagjeri i projektit
3. Ing.dip. ndrtimtarisë një

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Lista e kontratave të realizuara për në tri vitet e fundit me deshmu me referenca ose raporte të pranimit teknik ku qart duhet të ceket emri i projektit, vlera vendi i realizimit dhe koha e realizimit**lista duhet të jetë origjinale e nënshkruar dhe e vulosur**
2. Menagjeri i projektit të caktohet me shkres**shkaresa duhet me qenë origjinale e nënshkruar dhe vulosur**
3. Ing.dip ndrtimtarisë -një **-diploma duhet të jetë e noterizuar**.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	"Arch Ndërtimi"	Gjilan	89,992.12 €
2.	"Tali" sh.p.k.	Gjilan	74,472.78 €
3.	"Dren" Inginjering	Skenderaj	75,226.17 €
4.	N.N.T. "Varna Komerc"	Kamenicë	79,189.13 €

5.	"G&A Consulting" & "Hajrushi"	Prishtinë	49,555.02 €
6.	"Royal Cert" dhe "Te Burimi"	Prishtinë	78,826.56 €
7.	"El Bau" sh.p.k. dhe "Rexha" sh.p.k.	Gjilan	80,600.00 €
8.	"Al-Riza" dhe "Pro Group"	Kllokot	96,102.17 €
9.	N.N.P. "Engineering"	Viti	68,555.52 €
10.	N.N.P. "Vision Project"	Gjilan	88,879.73 €

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se në hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 9 (nënd) OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi, në procesverbal nuk është paraqitur ndonjë vëretje në lidhje me hapjen e ofertave.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

1. Kryetar i komisionit: Fadil SHERIFI
2. Anëtar i komisionit: Fitnete MJAKU
3. Anëtar i komisionit: Ramadan GASHI

Data e mbarimit të vlerësimit:.....10.03.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.13.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

të deklarohet komisioni ri - vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim

Për këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar dhjetë (10) oferta komisioni Ri- vlerësues gjashtë (6) nga këto nuk i ka trajtuar fare, sepse komisioni i
mëparshëm i vlerësimit i ka shpallur të papërgjegjshme dhe i ka eliminuar gjatë fazës së vlerësimit

Kanë mbetur ofertat e katër (4) Operatorëve Ekonomik të cilët për këtë aktivitet të prokurimit
kanë dorëzuar oferta të përgjegjëshme. Ofertuesve të
cilët kanëdorëzuar oferta të përgjegjëshme,më datë 06/03/2017 iu është dërguar kërkesa përmes
postëselektronike që të zgjatin afatin e vlefshmërisë
së ofertave si dhe të bëjnëzgjatjen e afatit të vlefshmërisë së vërtetimit të sigurimit të ofertave.
Kësaj kërkese iu janë përgjigjur vetëm dy Operatorë
Ekonomik: G&A CONSULTING" SHPK "HAJRUSHI" PRISHTINË, dhe NNP "ENGINEERING"
VITI. Këto dy oferta edhe një herë janë ekzaminuar,
vlerësuar dhe krahasuar nga komisioni përri–vlerësim, sipas vendimit të Panelit Shqyrtues të
Organit Shqyrtues të Prokurimit në përputhje me
procedurat dhe kriteret e përcaktuara në Njoftiminpër kontratë dhe në dokumentet e Dosjes së
Tenderit dhe ka konstatuar së të dy (2) këto oferta janë të përgjegjëshme.

Operatori Ekonomik i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e specifikuara në Njoftimin për
Kontratë dhe në dokumentet e Dosjes e Tenderit dhe ka dorëzuar oferten e përgjegjshme me çmimin
më të ulët është "G&A CONSULTING" SHPK "HAJRUSHI" PRISHRINË49,554.87 €. Sipas
konstatimit të komisionit për ri – vlerësim oferta e këtij operatori ekonomik ka qenë jo normalisht

e ulët, çka është kërkuar nga i njejti që të na dërgoi një deklaratë
me shkrim në të cilën do të përfshihet një zbërthim i detajuar i pjesëve relevantetë ofertës – tenderit kërkuar që të paraqes një shpjegim, një
ndarje të elementeve përbërëse të tenderit lidhur me çmimin e ulët të vendosur në ofertën –tenderin e tij.OE në afatin e paraparë në kërkesën të cilën ia kemi dërguar është përgjigjur me argumente mjaft bindëse se pse çmimi i ofertës së tij ka qënë jo normalisht i ulët me të cilat argumente është
bindur komisioni për ri – vlerësimin e ofertave.
Komisioni i caktuar për rivlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit duke i pasur para sysh të gjitha arsyet të cilat u ceken më lartë me qëllim të shfrytëzimit
sa me racional të fondeve publike dhe përkushtimit në ruajtjen e këtyre fondeve i propozon Zyrtarit Përgjegjes të Prokurimit që me kontratë të shpërblehet Operatori Ekonomik G&A CONSULTING" SHPK "HAJRUSHI" Prishtinë për çmimin i cili është i shënuar në ofertën e tij dhe i cili është lexuar me rastin e hapjës së ofertave më një korigjim të vogël 49,554.87 €.

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1: Autoriteti Kontraktues – **Komuna e Gjilanit** me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i urave në lagjen Biçak, Bilallët, Limonët dhe në lagjen Kurteshaj-Bresalc"**, me nr. të prokurimit: **651/16/069/521**, ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, kontratë publike në vlerë të mesme.
Operatori ekonomik ankues: **N.N.P."Engineering"** , fillimisht ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK për këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për dhënie të kontratës me pretendimet ankimore se është bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, dhe atë të nenit: 7, 59 pika 4, 69 pika 2.1,4.1 dhe 6.1 dhe Legjislacioni dytësor nenet 1.2.3 dhe 4 të LPP-së në fuqi.
AK- Komuna e Gjilanit ka kthyer përgjigjeje ndaj operatorit ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit dhe ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. OE ankues për të njëjtin aktivitet të prokurimit ju është drejtuar OSHP-së me ankesë me datën: 16.03.2017, kundër OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Sqarimi 2: Lidhur me pretendimin operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7, 59 dhe 69 të LPP-së, duke deklaruar se OE i rekomanduar për kontrat NUK ka ofruar kontrat apo para kontrat për inxhinierin e ndërtimit z.Ridvan Aliu. Lidhur me pretendimin operatorit ekonomik ku lidhen tek kërkesat e AK-së të përcaktuar në pikën 9.1 dhe pika 9.2, pozicioni 3 të FDT-së ku kërkohet:
1.Kontrata për punë të ngjajshme (ndërtimi i urave ose objekte të ndërtimit të lartë) për tri vitet e fundit së paku dy kontrata
2.Menagjeri i projektit
3.Ing.dip. ndrtimtarisë një
Dëshmia e kërkuar dokumentare
*1.Lista e kontratave të realizuara për në tri vitet e fundit me deshmu me referenca ose raporte të pranimit teknik ku qart duhet të ceket emri i projektit, vlera vendi i realizimit dhe koha e realizimit**lista duhet të jetë origjinale e nënshkruar dhe e vulosur***
*2.Menagjeri i projektit të caktohet me shkres**shkaresa duhet me qenë origjinale e nënshkruar dhe vulosur***
*3.Ing.dip ndrtimtarisë -një -**diploma duhet të jetë e noterizuar.***

Eksperti shqyrtues këtë pretendim ankimor e kualifikon si të pabazuara, pasi që në shkresat e ofertës

të OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi diplomën të ndërtimtarisë për ing.Ridvan Aliu të noterizuar dhe listën e stafit të punës, si dhe vendimin e konzerciumit të OE "G&A Consulting" sh.p.k. "Hajrushi", ku AK ka kërkuar në pikën 9.1 dhe 9.2, të FDT-së pika 3.

Poashtu ekspertit shqyrtues njofton panelin shqyrtues se kemi të bëjmë me pretendim ankimor i cili paraprakisht është shqyrtuar nga ana e ekspertit shqyrtues në ankesën e parashtruar me nr.prot.478/16, por i njëjti pretendim ankimor NUK është shqyrtuar në vendimin e PSH. Nr.478/16 i datës 06.02.2017.

Sqarimi 3: Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankues ku thuhet: *"OE i rekomanduar për kontratë gjatë ekzaminimit të dosjes së konzerciumit të shpallur fitues shihet se komisioni i vlerësimit nuk e ka konsideruar si ofertë abnormalisht të ulët edhe pse parashikimi i AK-së ka qenë 110,000.00 € ndërsa oferta e shpërblyer është 49,555.02 € zbërthyer në përqindje 55% nën parashikimin e AK-së.*

Eksperti shqyrtues pretendimin ankimor e kualifikon si të pa-bazuara, pasi që Autoriteti kontraktues në harmoni me nenin 61 të LPP-së ka kërkuar s'qarim me shkrim nga ana e OE të rekomanduar për kontrat dhe i njëjti OE është përgjigjur me shkrim duke s'qaruar në lidhje me çmimet e ofruar, ndërsa s'qarimi i dhënë nga ana e OE të rekomanduar për kontrat është pranuar si i mjaftueshëm nga ana e komisionit ri-vlerësues. Poashtu eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me formulen e krahasimit të çmimeve ndërmjet ofertuesve, në rastin konkret në këtë fazë NUK mundet të aplikohet kjo formul pasi që kemi vetëm dy operatoret ekonomik të përgjegjshëm, OE ankues dhe OE të rekomanduar për kontrat, të cilet sipas kërkesës së AK-së për vazhdimin e validitetit kanë pranuar të bëjmë vazhdimin e validitetit ndërsa OE të tjera NUK kanë vazhduar validitetin e ofertave sipas kërkesës së AK-së dhe të njëjtit janë të papërgjegjshëm.

Sqarimi 4: Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankues ku thuhet: nuk i është mundësuar qasja, Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i pabazuar, duke u bazuar në atë se i njëjti në ankes potencon se AK-ja i ka mundësuar qasje në dokumentat zyrtare konkretisht në ofertën e OE të rekomanduar për kontrat, dhe i njëjti OE ankues është në kundërthënie me vetveten, dhe në bazë të shkresave të lendes vërtetohet se i njëjti kishte qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontrat.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në s'qarimet e lartë cekura për këtë aktivitet të prokurimit: **"Ndërtimi i urave në lagjen Biçak, Bilallët, Limonët dhe në lagjen Kurteshaj-Bresalc"**, me nr. të prokurimit: **651/16/069/521**, i **rekomandoj** panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit Ekonomik ankues të REFUZOJ si të pa-bazuar, ndërsa vendimin e Autoriteti Kontraktues të APROVOJ, si të bazuar njoftimin për dhënie të kontratës të datës: 14.03.2017.